

të luftës, familjarët e Shkurtes dhe të Zizes për një kohë të gjatë i kanë kërkuar mbetjet e tyre mortore, por pa sukses. Për fatin e tyre nuk dihet asgjë as sot.

Burimet: deklarata D.T, FDH-18708; KMDLNI, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 156,157, FDH-23816; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Rexhep (Ethem) Ahmetaj

(1926, shqiptar nga Batusha/Batuša, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, një fëmijë)

Ryve (Osë Goçi) Ahmetaj

(1931, shqiptare nga Batusha/Batuša, komuna e Deçanit/Deçani, një fëmijë)

Rexhepi i moshëthyer me bashkëshorten Ryven jetonin te e bija Drita në fshatin **Pobërgjë/Pobrde**, që nga viti 1996. Kur forcat serbe depërtuan në fshat më **1.06.1998**, ata mbetën vetëm në shtëpi, pasi që të gjithë familjarët e tjerë e kishin braktisur shtëpinë më herët. Pas kthimit nga mërgimi, Drita e kishte gjetur shtëpinë e vetë të djegur, por nuk kishte gjetur asnjë gjurmë të babait Rexhep dhe nënës Ryve. Për fatin e tyre ende nuk dihet asgjë. Në listën e personave të zhdukur që e administron KNKK-ja, rasti i Rexhepit është evidentuar me numrin BLG-804782-01, ndërkaq ai i Ryves BLG-804782-02.

Burimet: deklarata D.T, FDH-18707; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Hasan (Bajram) Tolaj

(28.04.1930, shqiptar nga Pobërgja/Pobrde, komuna e Deçanit/Deçani, bujk)

Hasani ka mbetur vetëm në shtëpi, kur familjarët e tij e braktisën fshatin, para se forcat serbe të depërtonin në **Pobërgjë/Pobrde** më **1.06.1998**. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët e kanë parë të gjallë. Pas kthimit nga mërgimi më 26.06.1999, ata e gjetën shtëpinë të djegur, por nuk kishte asnjë gjurmë të Hasanit. I gjetën vetëm çizmet e Hasanit, të cilat ai i kishte në ditën kur ata e kishin lënë pas vete në shtëpi. Zhdukja e Hasanit është evidentuar nga KNKK-ja në lëndën që e mban numrin rendor BLG-803311-01.

Burimet: deklarata S.T, FDH-18711; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Isa (Zenun) Mataj

(5.05.1920, shqiptar nga Pobërgja/Pobrde, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, tre fëmijë)

Mone (Isuf Tahiraj) Mataj

(1928, shqiptar nga Pobërgja/Pobrde, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, tre fëmijë)

Isa me bashkëshorten Monen jetonin në bashkësi familjare me djalin Ahmetin dhe familjen e tij. Në datën 27.05.1998, ata kaluan në shtëpinë e Miftar Matajt, i cili ishte i afërmi i tyre dhe punonte në Zvicër. Shtëpia e Miftarit ishte paksa më larg shtëpive të tjera të fshatit. Në mëngjesin e datës **1.06.1998**, kur forcat serbe e nisën sulmin ndaj fshatit, Ahmeti dhe familja e tij menjëherë e braktisën shtëpinë, por Isa me Monen vazhduan të qëndronin në **Pobërgjë/Pobrde**. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët i shihnin të gjallë. Në fillim të qershorit të vitit 1999, Ahmeti me familje u kthyen në fshat. Shtëpia ishte e djegur dhe e rrënuar, ndërkaq prindërit e tij mungonin. Zhdukja e Isës është evidentuar nga KNKK-ja në lëndën që mban numrin rendor BLG-802255-01, ndërkaq ajo e Mones BLG-802255-02.

Burimet: deklarata N.M, FDH-18710; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Osman (Ramë) Tolaj

(16.07.1917, shqiptar nga Pobërgja/Pobrde, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, katër fëmijë)

Ukë (Ramë) Tolaj

(1922, shqiptar nga Pobërgja/Pobrde, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, një fëmijë)

Vëllezërit Osmani dhe Uka kanë mbetur vetëm në shtëpi kur familjarët e tyre e braktisën **Pobërgjën/Pobrde** në datën **1.06.1998**, duke kaluar në Shqipëri. Pas kthimit nga mërgimi, nga fundi i qershorit të vitit 1999, familjarët e gjetën shtëpinë e vet të djegur, por nuk kishte asnjë gjurmë të pleqve të tyre. Zhdukja e Osmanit është evidentuar nga KNKK-ja në lëndën që e mban numrin rendor BLG-801285-01, ndërkaq ajo e Ukës me